



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 167

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 1 tetor 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 95/2024, datë 12.9.2024	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 28.8.2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 ‘Për buxhetin e vitit 2024’”, i ndryshuar.....	19623
Dekret i Presidentit nr. 348, datë 30.9.2024	Për shpallje ligji.....	19623
Ligj nr. 97/2024, datë 12.9.2024	Për ratifikimin e letrës së pjesëmarrjes së Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në memorandumun e mirëkuptimit për Qendrën Evropiane të Ekselencës kundër kërcënimeve hibride.....	19623
Dekret i Presidentit nr. 346, datë 27.9.2024	Për shpallje ligji.....	19636
Ligj nr. 101/2024, datë 12.9.2024	Për një shtesë në ligjin nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”	19636
Dekret i Presidentit nr. 347, datë 27.9.2024	Për shpallje ligji.....	19636
Vendim i Kuvendit nr. 92/2024, datë 19.9.2024	Për rrëzimin e listës së parë në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor përfaqësues të shoqërisë civile sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.....	19636
Vendim i Kuvendit nr. 93/2024, datë 19.9.2024	Për zgjedhjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.....	19637
Vendim i Kuvendit nr. 94/2024, datë 19.9.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar	19637
Vendim i Kuvendit nr. 95/2024, datë 19.9.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar.....	19637

Dekret i Presidentit nr. 349, datë 30.9.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	19638
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 178, datë 3.9.2024	Mbi fillimin e procedurës, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a., për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekës) të aseteve fikse të saj....	19638
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ermir Jahelezi.....	19639

LIGJ
Nr. 95/2024**PËR MIRATIMIN E AKTIT
NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT,
NR. 3, DATË 28.8.2024, “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN
NR. 97/2023 ‘PËR BUXHETIN E VITIT
2024’”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3 datë 28.8.2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023, ‘Për buxhetin e vitit 2024’”, i ndryshuar.

Miraturar në datën 12.9.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 348, datë 30.9.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

**DEKRET
Nr. 348, datë 30.9.2024**

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 95/2024, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 28.8.2024, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023, Për buxhetin e vitit 2024, i ndryshuar’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 97/2024**PËR RATIFIKIMIN E LETRËS SË
PJESËMARRJES SË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË MEMORANDUMIN E
MIRËKUPTIMIT PËR QENDRËN
EVROPIANE TË EKSELENCËS
KUNDËR KËRCËNIMEVE HIBRIDE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet letra e pjesëmarrjes së Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në memorandumin e mirëkuptimit për Qendrën Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibride, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.9.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 346, datë 27.9.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

**MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT
PËR QENDRËN EVROPIANE TË
EKSELENCËS KUNDËR KËRCËNIMEVE
HIBRIDE**

Nënshkruesit e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (në vijim referuar si “Pjesëmarrësit”);
duke pasur parasysh Komunikimin e Përbashkët të Komisionit Evropian dhe Përfaqësuesit të Lartë në Parlamentin Evropian, dhe Këshillin “Korniza e përbashkët për luftën kundër kërcënimeve hibride,



një reagim i Bashkimit Evropian”, i vendosur në Bruksel më 6 prill 2016, në të cilën Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian (“BE”) të marrin në konsideratë krijimin e një Qendre Ekselence “kundër kërcënimeve hibride”;

duke pasur parasysh Deklaratën e Përbashkët të Presidentit të Këshillit Evropian, Presidentit të Komisionit Evropian dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (“NATO”), nënshkruar në Varshavë më 8 korrik 2016, e cila thekson nevojën për BE-në dhe NATO-n, si dhe shtetet anëtare të BE-së dhe aleatët e NATO-s, për të rritur aftësinë e tyre për luftën kundër kërcënimeve hibride; dhe

duke pasur parasysh grupin e përbashkët të propozimeve për zbatimin e Deklaratës së Përbashkët BE/NATO, të miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Këshilli i Atlantikut të Veriut më 6 dhjetor 2016, i cili nxit pjesëmarrjen e BE-së dhe të NATO-s, si dhe të shteteve anëtare të BE-së dhe aleatët e NATO-s, në punën e “Qendrës Evropiane kundër Kërcënimeve Hibride” që do të krijohet në vitin 2017,

kanë rënë dakord si në vijim:

Seksioni 1

Themelimi i Qendrës Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibride

Pjesëmarrësit theksojnë se Qendra Evropiane e Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibride (në tekstin e mëtejshëm “Qendra”) pritet të krijohet në Helsinkë, Finlandë, siç përcaktohet në seksionin 2 të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

Seksioni 2

Selia ligjore

Qëllimi është që qendra të ketë një seli ligjore vendëse dhe kapacitet për të ndërmarrë funksionet e saj në Republikën e Finlandës. Nëpërmjet legjislacionit kombëtar, Qendra pritet të ketë, në territorin e Republikës së Finlandës, zotësi juridike të nevojshme për ushtrimin e plotë të funksioneve të saj dhe që i parashikohet nga ligjet e Republikës së Finlandës.

Seksioni 3

Qëllimi dhe funksioni

1. Duke angazhuar personelin dhe duke përdorur burimet e tjera të kontribuara nga Pjesëmarrësit (“Personeli i Qendrës”), Qendra pritet të shërbejë si një qendër ekspertize që mbështet përpjekjet individuale dhe të përbashkëta të Pjesëmarrësve për të rritur, aftësitë e tyre civile dhe ushtarake, qëndrueshmërinë dhe gatishmërinë për të luftuar kërcënimet hibride me fokus të veçantë në sigurinë evropiane. Qëllimi që Qendra do të ofrojë këtë ekspertizë dhe përvojë të përbashkët për të mirën e të gjithë Pjesëmarrësve, si dhe të BE-së dhe NATO-s.

2. Gjatë punës së saj, Qendra synon të ndjekë një qasje gjithëpërfshirëse, shumëkombëshe, multidisiplinare dhe akademike.

3. Për të arritur qëllimin e saj, Qendra pritet të:

a) nxisë dialogun dhe konsultimet në nivel strategjik ndërmjet Pjesëmarrësve, BE-së dhe NATO-s;

b) kryejë kërkime dhe analiza mbi kërcënimet hibride dhe metodat kundër kërcënimeve të tilla;

c) zhvillojë konceptet, të kryejë trajnime dhe të organizojë ushtrime që synojnë rritjen e aftësive individuale të Pjesëmarrësve, si dhe ndërveprimin ndërmjet Pjesëmarrësve, BE-së dhe NATO-s kundër kërcënimeve hibride;

d) angazhohet dhe të ftojë për dialog me ekspertë shtetërorë dhe joshtetërorë nga një gamë e gjerë sektorësh dhe disiplinash profesionale; dhe

e) përfshijë ose të bashkëpunojë me komunitetet e interesit, duke u fokusuar në aktivitete specifike që, së bashku ose vetëm, mund të përbëjnë kërcënime hibride; mbi metodologjitë për të kuptuar natyrën e këtyre aktiviteteve; dhe mbi mënyrat për të përshtatur organizatat për të trajtuar kërcënime të tilla në mënyrë më efektive.

Seksioni 4

Organet

1. Organet e Qendrës do të jenë Bordi Drejtues dhe Sekretariati. Sekretariati do të drejtohet nga një drejtor.

2. Përfaqësuesit e stafit nga BE-ja dhe NATO-ja do të ftohen për t'u bashkuar në aktivitetet e Qendrës, duke përfshirë pjesëmarrjen në mbledhjet e Bordit Drejtues, megjithatë, me kusht që as NATO-ja dhe as BE-ja nuk do të jenë pjesëmarrëse



në Qendër dhe nuk do të kenë të drejtë vote në Bordin Drejtues.

Seksioni 5 Bordi Drejtues

1. Bordi Drejtues përbëhet nga përfaqësues të Pjesëmarrësve dhe duhet:

- a) të emërojë drejtorin e Qendrës;
- b) të zgjedhë kryetarin e Bordit Drejtues, i cili do të kryesojë mbledhjet e Bordit Drejtues, për 3 (tre) vjet;
- c) të përcaktojë politikat dhe të miratojë programin e punës së Qendrës;
- d) të miratojë buxhetin dhe llogaritë e Qendrës me propozim të drejtorit;
- e) të miratojë tarifat vjetore të pjesëmarrjes të përcaktuara në seksionin 7;
- f) të miratojë pranimin e Pjesëmarrësve të rinj, në përputhje me seksionin 11;
- g) të marrë vendime dhe të miratojë rregullore të brendshme për çështje të përgjithshme të natyrës teknike, financiare ose administrative, duke përfshirë rregullat e sigurisë së brendshme, që do t'i bashkëlidhen dokumenteve plotësuese, si shtojcat dhe anekset, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit;
- h) të miratojë udhëzimet e nevojshme për funksionimin e Qendrës dhe të organeve të saj; dhe
- i) të miratojë dhe të ndryshojë Rregulloren e Procedurës së Qendrës.

2. Vendimet duhet të merren me konsensus të anëtarëve të Bordit Drejtues të pranishëm dhe që kanë të drejtë vote, përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Memorandum të Mirëkuptimit ose në Rregulloren e Procedurës. Konsensusi përcaktohet me votën e çdo pjesëmarrësi “pro”, “kundër” ose “abstenim” nga votimi. Në mënyrë që një vendim të miratohet, duhet të ketë të paktën një votë “pro”. Nëse votohet “kundër”, vendimi nuk miratohet me konsensus.

Seksioni 6 Sekretariati

Sekretariati, i kryesuar nga drejtori, përbëhet nga personeli i Qendrës.

Sekretariati:

a) menaxhon administrimin dhe funksionet e përbashkëta të Qendrës: trajnime, ushtrime dhe konsultime, kërkime dhe teknologji;

b) mirëmban dhe administron faqen e internetit të Qendrës;

c) analizon dhe koordinon aktivitetet përkatëse të komuniteteve të interesit;

d) përgatit dhe organizon mbledhjet e Bordit Drejtues; dhe

e) bashkëpunon dhe komunikon me Pjesëmarrësit, BE-në dhe NATO-n.

Seksioni 7 Burimet

1. Buxheti i Qendrës, i cili pritet të mbulojë kostot që lidhen me pjesëmarrjen, në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, përbëhet nga:

- a) tarifat vjetore të pjesëmarrjes; dhe
- b) kontributet financiare vullnetare;

2. Finlanda është përgjegjëse për kostot që lidhen me mirëmbajtjen e objekteve të Qendrës, të tilla si marrja me qira e objekteve dhe kostot e jashtme të sigurisë.

3. Pjesëmarrësit, si dhe organizatat ndërkombëtare të ftuara, mund t'i sigurojnë Qendrës burime të tjera dhe kontribute në natyrë, si personeli, në varësi të disponueshmërisë së fondeve dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

4. Kushtet dhe afatet që lidhen me çdo ofrim të tillë të personelit nga çdo pjesëmarrës, ose mbështetje nga organizatat ndërkombëtare të ftuara, duhet të përcaktohen në dokumente shtesë, të tilla si anekset dhe shtojcat e Memorandumit të Mirëkuptimit, të cilat do të përbëjnë një pjesë integrale e këtij MM-je.

Seksioni 8 Siguria

1. Republika e Finlandës është përgjegjëse për sigurinë e jashtme të Qendrës.

2. Drejtori ose një person i caktuar është përgjegjës për sigurinë brenda Qendrës, duke përfshirë menaxhimin e vizitave, lejet e sigurisë dhe sigurinë e informacionit, duke vepruar në përputhje me rregulloret e sigurisë së Qendrës të miratuara nga Bordi Drejtues.



3. Informacioni konfidencial i ruajtur, menaxhuar, gjeneruar, transmetuar ose shkëmbyer sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, ose në lidhje me ndonjë aktivitet të Qendrës, duhet t'u nënshtrohet kushteve të çdo marrëveshjeje të zbatueshme në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e tyre.

4. Rregullat e brendshme të sigurisë së Qendrës duhet të përcaktojnë kërkesat minimale të përbashkëta për mbrojtjen e informacionit konfidencial të menaxhuar në Qendër sipas rastit. Në rast se këto rregulla nuk janë në përputhje me ose janë më pak mbrojtëse se çdo Marrëveshje Informacioni, do të mbizotërojnë kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Pjesëmarrësit synojnë të zgjidhin çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi vetëm nëpërmjet konsultimeve, pa përfshirë ndonjë gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare ose palë të tretë.

Seksioni 10

Nënshkrimi dhe data e hyrjes në fuqi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi fillimisht do të jetë i disponueshëm për nënshkrim nga Qeveria e Republikës së Austrisë, Mbretëria e Danimarkës, Republika e Estonisë, Republika e Finlandës, Republika e Francës, Republika Federale e Gjermanisë, Republika Italiane, Republika e Letonisë, Republika e Lituanisë, Mbretëria e Holandës, Mbretëria e Norvegjisë, Republika e Polonisë, Mbretëria e Spanjës, Mbretëria e Suedisë, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

2. Ky Memorandum Mirëkuptimi pritet të hyjë në fuqi në datën në të cilën 5 (pesë) nga shtetet e renditura në paragrafin 1 të këtij seksioni, duke përfshirë Qeverinë e Republikës së Finlandës, e kanë nënshkruar atë. Sekretariati duhet t'i informojë ata nënshkruar për datën e hyrjes në fuqi.

3. Për çdo shtet të renditur në paragrafin 1, që nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit pasi ai të ketë hyrë në fuqi, Memorandumi i Mirëkuptimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

Seksioni 11

Pjesëmarrja shtesë

1. Pasi Memorandumi i Mirëkuptimit të ketë hyrë në fuqi, Bordi Drejtues, me një vendim të marrë nga shumica e thjeshtë, mund të ftojë Qeverinë e çdo shteti që nuk listohet në paragrafin 1 të seksionit 10 që është anëtar në BE ose NATO për të marrë pjesë në bashkëpunimin, sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

2. Në rast se zgjedh të marrë pjesë, qeveria e çdo shteti të ftuar, sipas paragrafit 1 të këtij seksioni, pritet të njoftojë Sekretariatit për synimin e vet për të marrë pjesë. Për këtë Shtet, Memorandumi i Mirëkuptimit synohet të hyjë në fuqi dhe Shteti në fjalë bëhet pjesëmarrës, në datën e marrjes së njoftimit nga Sekretariati.

Seksioni 12

Ndryshimet

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e përbashkët me shkrim të Pjesëmarrësve. Sekretariati njofton Pjesëmarrësit në rast se një ndryshim hyn në fuqi.

Seksioni 13

Vlefshmëria dhe heqja dorë

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi është nënshkruar për një periudhë të pacaktuar.

2. Një pjesëmarrës mund të tërhiqet nga ky Memorandum Mirëkuptimi në çdo kohë, por duhet të përpiqet të njoftojë me shkrim Sekretariatit 3 (tre) muaj përpara për tërheqjen, i cili duhet të njoftojë menjëherë Pjesëmarrësit e tjerë për këtë njoftim, me kusht që, megjithatë, angazhimet sipas seksionit 8 duhet t'i mbijetojnë çdo ndërprerjeje të këtij Memorandumi Mirëkuptimi ose tërheqjeje nga ndonjë pjesëmarrës.

Seksioni 14

Ndërprerja

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndërpritet nëse në çdo kohë pasi të hyjë në fuqi ka më pak se 4 (katër) pjesëmarrës, ose nëse Republika e Finlandës vendos të ndërpresë pjesëmarrjen e vet.



2. Nëse Memorandumi i Mirëkuptimit ndërpritet, pritët që Pjesëmarrësve do t'u lejohet 6 (gjashtë) muaj nga çdo njoftim i ndërprerjes për të mbyllur çdo veprimtari sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, që ishin duke u zhvilluar në momentin e kësaj ndërprerjeje, me kusht që, megjithatë, se angazhimet sipas seksionit 8 duhet t'i mbijetojnë çdo ndërprerjeje të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit ose tërheqjes nga ndonjë pjesëmarrës.

Seksioni 15

Marrëdhënia me të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk garanton asnjë të drejtë ose detyrim, sipas ligjit ndërkombëtar ose ligjeve të ndonjë pjesëmarrësi.

2. Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk është i pranueshëm për regjistrim sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Ky Memorandum Mirëkuptimi është nënshkruar në Helsinki më 11 prill në një kopje origjinale në gjuhën angleze. Kopja origjinale e këtij Memorandumi Mirëkuptimi duhet të mbahet nga Sekretariati, i cili duhet t'i dërgojë kopje të vërtetuara secilit prej Pjesëmarrësve.

Për Qeverinë e Republikës së Austrisë
Për Qeverinë e Mbretërisë së Danimarkës
Për Qeverinë e Republikës së Estonisë
Për Qeverinë e Republikës së Finlandës
Për Qeverinë e Republikës së Francës
Për Qeverinë e Republikës së Gjermanisë
Për Qeverinë e Republikës së Italisë
Për Qeverinë e Republikës së Letonisë
Për Qeverinë e Republikës së Lituanisë
Për Qeverinë e Mbretërisë së Holandës
Për Qeverinë e Mbretërisë së Norvegjisë
Për Qeverinë e Republikës së Polonisë
Për Qeverinë e Mbretërisë së Spanjës
Për Qeverinë e Mbretërisë së Suedisë

Për Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut

Për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

SHTOJCA A

DREJTUAR: Drejtores Teija Tiilikainen, Qendra Evropiane e Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibrade

PËR DIJENI TË: Kryetarit Jarmo Lindberg, Bordi Drejtues i Qendrës Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibrade

DATA:

LETËR INTERESI

NË LIDHJE ME PJESËMARRJEN NË MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT PËR QENDRËN EVROPIANE TË EKSELENCËS KUNDËR KËRCËNIMEVE HIBRIDE

Kjo letër shpreh interesin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të marrë pjesë në Qendrën Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibrade (Hybrid CoE) me qendër në Helsinki, Finlandë.

Pika kryesore e kontaktit, në lidhje me interesin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të marrë pjesë, do të jetë z. Igli Tafa, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, *email*: igli.tafa@cesk.gov.al.

Ju falënderojmë për marrjen në konsideratë të kësaj letrë interesi dhe jemi në pritje të përgjigjes suaj.

Me respekt,
Igli Tafa
(Nënshkrimi)

SHTOJCA B

NJOFTIM

LIDHUR ME PJESËMARRJEN NË MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT PËR QENDRËN EVROPIANE TË EKSELENCËS KUNDËR KËRCËNIMEVE HIBRIDE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, duke pranuar arsyetimet e përcaktuara në Memorandumin e Mirëkuptimit (në vijim i referuar si “MM”) për Qendrën Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibrade (në vijim e referuar si “Qendra Evropiane e Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibrade”), si dhe vendimet e marra nga Bordi Drejtues i Qendrës Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibrade, si



miratimi i Rregullave të Procedurës dhe rregulloreve të brendshme; dhe

duke pasur parasysh që Bordi Drejtues i Qendrës Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibride ka vendosur të ftojë Republikën e Shqipërisë që të marrë pjesë në bashkëpunim në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit për Qendrën Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibride,

nëpërmjet kësaj shkrese njofton pjesëmarrjen në Memorandumin e Mirëkuptimit për Qendrën Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibride, i cili ka hyrë në fuqi më 11 prill 2017,

dhe informon se përfaqësuesi i tij kombëtar do të emërohet nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike dhe tarifa vjetore e pjesëmarrjes do të paguhet nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike.

Në datën e marrjes së këtij njoftimi nga Sekretariati, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të bëhet pjesëmarrëse në MM.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Vendi, data:

Pozicioni: Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

Emri: Igli Hasani

Nënshkrimi:

Njoftimi merret nga Sekretariati:

Vendi, data: Helsinki,

Pozicioni: Drejtor i Qendrës Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibride

Emri: Teija Tiilikainen

Nënshkrimi:

Memorandum of Understanding

ON THE EUROPEAN CENTRE OF EXCELLENCE FOR COUNTERING HYBRID THREATS

The Signatories to this Memorandum of Understanding (hereafter the "Participants");

Recalling the Joint Communication by the European Commission and the High Representative to the European Parliament and the Council "Joint framework on countering hybrid threats – a European Union response," decided in Brussels on 6 April 2016, in which European Union ("EU") Member States are invited to consider establishing a Centre of Excellence for "countering hybrid threats";

Recalling the Joint Declaration by the President of the European Council, the President of the European Commission, and the Secretary General of the North Atlantic Treaty Organization ("NATO"), signed at Warsaw on 8 July 2016, which underlines the need for the EU and the NATO as well as EU Member States and NATO Allies, to boost their ability to counter hybrid threats; and

Recalling the Common set of proposals for the implementation of the Joint EU/NATO Declaration, endorsed by the Council of the European Union and the North Atlantic Council on 6 December 2016, which encourages participation by the EU and NATO, as well as EU Member States and NATO Allies, in the work of the "European Centre for Countering Hybrid Threats" to be established in 2017;

Have reached the following understanding:

Section 1

Establishment of the European Centre of Excellence for Countering Hybrid Threats

The Participants note that a European Centre of Excellence for Countering Hybrid Threats (hereafter "the Centre") is expected to be established in Helsinki, Finland, as set forth in Section 2 of this Memorandum of Understanding.

Section 2

Legal personality

The Centre is intended to have a domestic legal personality and capacity to perform its functions in the Republic of Finland. Through national legislation, the Centre is expected to enjoy, in the territory of the Republic of Finland, such legal capacity as is necessary for the full exercise of its functions and is afforded to it by the laws of the Republic of Finland.



Section 3

Purpose and functions

1. Utilizing personnel and other resources contributed by the Participants (the “Personnel of the Centre”), the Centre is expected to serve as a hub of expertise supporting the Participants’ individual and collective efforts to enhance their civil-military capabilities, resilience, and preparedness to counter hybrid threats with a special focus on European security. It is intended that the Centre will offer this collective expertise and experience for the benefit of all Participants, as well as the EU and NATO.
2. In carrying out its work, the Centre intends to follow a comprehensive, multinational, multidisciplinary and academic-based approach.
3. In order to achieve its purpose, the Centre is expected to:
 - a) encourage strategic-level dialogue and consultations between and among Participants, the EU, and NATO;
 - b) conduct research and analysis into hybrid threats and methods to counter such threats;
 - c) develop doctrine, conduct training, and arrange exercises aimed at enhancing Participants’ individual capabilities, as well as interoperability between and among Participants, the EU, and NATO for countering hybrid threats;
 - d) engage with and invite dialogue with government and non-government experts from a wide range of professional sectors and disciplines; and
 - e) involve, or cooperate with, communities of interest focusing on specific activities that, whether together or in isolation, may constitute hybrid threats; on methodologies for understanding the nature of these activities; and on ways to adjust organisations to address such threats more effectively.

Section 4

Organs

1. The organs of the Centre are to be a Steering Board and a Secretariat. The Secretariat is to be headed by a Director.
2. Staff representatives from the EU and NATO are to be invited to join in the activities of the Centre, including attendance at the Steering Board meetings, provided, however, that neither NATO nor the EU is to be a Participant in the Centre, nor is either entitled to a vote on the Steering Board.

Section 5

Steering Board

1. The Steering Board is to consist of representatives of the Participants and is to:
 - a) appoint the Director of the Centre;
 - b) select the Chair of the Steering Board, who is to preside at the meetings of the Steering Board, for a term of three (3) years;
 - c) set the policies and approve the work program of the Centre;



- d) approve the budget and the accounts of the Centre on proposal of the Director;
 - e) approve the annual participation fees referred to in Section 7;
 - f) approve the admission of new Participants, in accordance with Section 11;
 - g) take decisions and adopt internal regulations on general issues of technical, financial, or administrative nature, including internal security rules, to be attached in supplementary documents, such as annexes and appendices, which are to form an integral part of this Memorandum of Understanding;
 - h) approve such guidance as may be necessary for the functioning of the Centre and its organs; and
 - i) approve and amend the Rules of Procedure of the Centre.
2. Decisions are to be taken by consensus of the Steering Board members present and voting, unless otherwise provided in this Memorandum of Understanding or in the Rules of Procedure. Consensus is determined upon every Participant voting "yes", "no", or abstaining from voting. For a decision to be approved, there must be a minimum of one "yes" vote. Should there be a "no" vote, the decision is not approved by consensus.

Section 6 **Secretariat**

The Secretariat, headed by the Director, is intended to be composed of the Personnel of the Centre.

The Secretariat is to:

- a) manage the Centre's administration and common functions: training, exercises and consulting, research and technology;
- b) maintain and administer the Centre's web site;
- c) analyse and coordinate relevant activities of the communities of interest;
- d) prepare and organize the meetings of the Steering Board; and
- e) cooperate and liaise with Participants, the EU, and NATO.

Section 7 **Resources**

1. The Centre's budget, which is expected to cover costs associated with participation, subject to the availability of funds and consistent with applicable laws and regulations, may consist of:
 - a) annual participation fees; and
 - b) voluntary financial contributions;
2. Finland is responsible for the costs related to maintenance of the Centre's facilities, such as facilities rental and external security costs.
3. The Participants, as well as invited International Organisations, may, subject to the availability of funds and consistent with applicable laws and regulations, provide the Centre with other resources and in-kind contributions, such as personnel.



4. The terms and conditions related to any such provision of personnel by any Participant, or support from invited International Organisations, are to be delineated in supplemental documents, such as annexes and appendices to the Memorandum of Understanding, which are to form an integral part of this MOU.

Section 8 ***Security***

1. The external security of the Centre is to be the responsibility of the Republic of Finland.
2. Security administration within the Centre's facilities, including visits, security clearances, and information security, is the responsibility of the Director or his/her designee, acting in accordance with the security regulations of the Centre as approved by the Steering Board.
3. Classified information stored, handled, generated, transmitted or exchanged under this Memorandum of Understanding, or in connection with any activities of the Centre, is to be subject to the terms of any applicable arrangements concerning their security and protection.
4. The Centre's internal security rules are to set out the common minimum requirements for the protection of classified information handled in the Centre as appropriate. In the event that such rules conflict with, or are less protective than, any Information Agreement, the terms of such Agreement are to prevail.

Section 9 ***Dispute settlement***

The Participants intend to resolve any dispute about the interpretation or application of this Memorandum of Understanding solely by consultations, and not to refer any such disputes to any national or international tribunal or third party for settlement.

Section 10 ***Signature and operative date***

1. This Memorandum of Understanding initially is to be open for signature by the Governments of the Republic of Austria, the Kingdom of Denmark, the Republic of Estonia, the Republic of Finland, the Republic of France, the Federal Republic of Germany, the Italian Republic, the Republic of Latvia, the Republic of Lithuania, the Kingdom of the Netherlands, the Kingdom of Norway, the Republic of Poland, the Kingdom of Spain, the Kingdom of Sweden, the United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland, and the United States of America.
2. This Memorandum of Understanding is intended to become operative on the date on which five (5) of the States listed in paragraph 1 of this Section, including the



Government of the Republic of Finland, have signed it. The Secretariat is to inform those signatories of the operative date.

3. For each State listed in paragraph 1 that signs the Memorandum of Understanding after it has become operative, the Memorandum of Understanding becomes operative on the date of its signature.

Section 11 ***Additional participation***

1. After the Memorandum of Understanding has become operative, the Steering Board, by a decision taken by a simple majority, may invite the Government of any State not listed in paragraph 1 of Section 10 that is a Member of the EU or of NATO to participate in cooperation under this Memorandum of Understanding.
2. Should it elect to participate, the Government of any State invited in accordance with paragraph 1 of this Section is expected to notify the Secretariat of its intention to participate. For such a State, the Memorandum of Understanding is intended to become operative, and that State is to become a Participant, on the date the notification is received by the Secretariat.

Section 12 ***Modifications***

This Memorandum of Understanding may be modified at any time by the unanimous written consent of the Participants. The Secretariat is to notify the Participants when a modification becomes operative.

Section 13 ***Validity and withdrawal***

1. This Memorandum of Understanding is concluded for an unlimited period.
2. A Participant may withdraw from this Memorandum of Understanding at any time but should endeavor to give three (3) months' written notice of the withdrawal to the Secretariat, which is to notify the other Participants immediately of such notice, provided, however, that the commitments under Section 8 are to survive any discontinuation of this Memorandum of Understanding or the withdrawal by any Participant.

Section 14 ***Discontinuation***

1. This Memorandum of Understanding may be discontinued if at any time after it becomes operative there are fewer than four (4) Participants, or if the Republic of Finland chooses to discontinue its participation.



2. If the Memorandum of Understanding is discontinued, it is expected that the Participants would be allowed six (6) months from any notice of discontinuation to close out any activities under this Memorandum of Understanding that were underway at the time of such discontinuation, provided, however, that the commitments under Section 8 are to survive any discontinuation of this Memorandum of Understanding or the withdrawal by any Participant.

Section 15

Relationship with national and international law

1. This Memorandum of Understanding does not create any rights or obligations under international law or the laws of any Participant.
2. This Memorandum of Understanding is not eligible for registration under Article 102 of the Charter of the United Nations.

This Memorandum of Understanding is signed at Helsinki on 11 April in one original in the English language. The original of this Memorandum of Understanding is to be kept by the Secretariat, which is to transmit certified copies to each of the Participants.

For the Government of the Republic of Austria

For the Government of the Kingdom of Denmark

For the Government of the Republic of Estonia

For the Government of the Republic of Finland

For the Government of the French Republic

For the Government of the Federal Republic of Germany

For the Government of the Italian Republic

For the Government of the Republic of Latvia

For the Government of the Republic of Lithuania

For the Government of the Kingdom of the Netherlands

For the Government of the Kingdom of Norway

For the Government of the Republic of Poland



For the Government of the Kingdom of Spain

For the Government of the Kingdom of Sweden

For the Government of the United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland

For the Government of the United States of America

ANNEX A.

TO: Director Teija Tiilikainen, European Centre of Excellence for Countering Hybrid Threats

COPY TO: Chairman Jarmo Lindberg, Steering Board of the European Centre of Excellence for Countering Hybrid Threats

DATE:

LETTER OF INTEREST
regarding participation in the Memorandum of Understanding
on the European Centre of Excellence for Countering Hybrid
Threats

This Letter signifies the interest of the Government of ALBANIA to become a Participant in the European Centre of Excellence for Countering Hybrid Threats (Hybrid CoE) based in Helsinki, Finland.

The principal point of contact with respect to the Government of ALBANIA's interest in participating will be Mr. IGLI TAFA, General Director of National Authority on Electronic Certification and Cyber Security, email: igli.tafa@cesk.gov.al.

We would like to thank you for considering this letter of interest and we look forward to hearing your response.

Yours faithfully,



ANNEX B.

NOTIFICATION
regarding participation in the Memorandum of Understanding
on the European Centre of Excellence for Countering Hybrid Threats

The Government of the Republic of Albania

Acknowledging the understandings set forth in the Memorandum of Understanding (hereafter the "MoU") on the European Centre of Excellence for Countering Hybrid Threats (hereafter "Hybrid CoE"), as well as decisions made by the Steering Board of Hybrid CoE, such as adoption of Rules of Procedure and Internal regulations,

And considering that the Steering Board of Hybrid CoE has taken a decision to invite the Republic of Albania to participate in cooperation under the MoU on Hybrid CoE,

Hereby provides its notification of intent to participate in the MoU on Hybrid CoE which became operative on 11 April 2017,

And advises that its national representative will be nominated by its National Cyber Security Authority and the annual participation fee will be paid by its National Cyber Security Authority.

It is understood that the Republic of Albania will become a Participant in the MoU on the date this notification is received by the Secretariat.

For the Government of the Republic of Albania

Place, Date: Helsinki, 13 June 2024
Rank, Position: Minister for Europe and Foreign Affairs
Name: IGL MASARI
Signature: [Signature]

Notification is received by the Secretariat:

Place, Date: Helsinki, 13 June 2024
Rank, Position: Director of Hybrid CoE
Name: Teija Tiilikainen
Signature: [Signature]



DEKRET
Nr. 346, datë 27.9.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 97/2024, “Për ratifikimin e letres së pjesëmarrjes së Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në memorandumin e mirëkuptimit për Qendrën Evropiane të Ekselencës kundër Kërcënimeve Hibride”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 101/2024

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.
43/2016, “PËR MARRËVESHJET
NDËRKOMBËTARE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 25 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Në rastet kur mënyra e zbatimit të detyrimeve të palës shqiptare në nivel të brendshëm nuk është rregulluar nga vetë marrëveshja bazë apo marrëveshjet zbatuese dhe as nuk buron nga tërësia e rregullimeve të legjislacionit në fuqi, rregullat për mënyrën e zbatimit të këtyre detyrimeve për palën shqiptare përcaktohen rast pas rasti me vendim të

Faqe | 19636

Këshillit të Ministrave ose me udhëzim të titullarit të institucionit zbatues të marrëveshjes, në varësi të përmbajtjes së çështjes që do të rregullohet.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.9.2024.

Shpallur me dekretin nr. 347, datë 27.9.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 347, datë 27.9.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 101/2024, “Për një shtesë në ligjin nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 92/2024

PËR RRËZIMIN E LISTËS SË PARË NË
BLLOK TË KANDIDATËVE
TË PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE
SIPAS LIGJIT NR. 115/2016,
“PËR ORGANET E QEVERISJES SË
SISTEMIT TË DREJTËSISË”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i



ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së parë në bllok të kandidatëve për anëtarë përfaqësues të shoqërisë civile të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Erion Fejzulla.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miraturar në datën 19.9.2024.

VENDIM
Nr. 93/2024

**PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERIT
PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 33 të ligjit nr. 9887, datë 15.2.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe neneve 55 e 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Besnik Dervishi zgjidhet Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miraturar në datën 19.9.2024.

VENDIM
Nr. 94/2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I, të vendimit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- Deputeti Niko Peleshi caktohet anëtar në Komisionin për Politikën e Jashtme;

- Deputetja Lindita Nikolla caktohet anëtare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miraturar në datën 19.9.2024.

VENDIM
Nr. 95/2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 70/2021, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË
PËRBËRJEN E KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën II, të vendimit nr. 70/2021, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Deputeti Niko Peleshi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Evropiane.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miraturar në datën 19.9.2024.

DEKRET
Nr. 349, datë 30.9.2024PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Eriola Mehdi Delija
2. Rajmonda Rifat Spahiu
3. Djellza Agron Istrefaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 178, datë 3.9.2024MBI FILLIMIN E PROCEDURËS,
LIDHUR ME SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË “AYEN AS
ENERGJI” SHA, PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
TRANSFERIMIN (NËPËRMJET
HIPOTEKËS) TË ASETEVE FIKSE
TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, germa “b”, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miraturar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miraturar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1774/1 prot., datë 2.9.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Ayen AS Energji’ sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekës) të aseteve të paluajtshme të saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen AS Energji” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Ura e Fanit”, “Fangu” dhe “Peshqesh”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015, të ndryshuar, me vendimin e Bordit nr. 128, datë 16.8.2017.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1174 prot., datë 19.8.2024, ajo ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit kundrejt marrëveshjes së kredisë sindikale, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., “OTP Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. dhe “Tirana Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është zgjedhur “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë, në zbatim të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miraturar



me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se në këtë aplikim nevojitet të plotësohet dhe sa më poshtë:

Neni 7, “Përmbajtja e kërkesës për transferim”

Pika 1: Një përshkrim i të licencuarit që përmban informacion mbi:

- germën “c”: shoqëria duhet të bëjë me dije efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- germën “d”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores, në lidhje me përshkrimin e kandidatit të propozuar për transferimin e aseteve;

- germën “e”: shoqëria duhet të japë informacion mbi mënyrën se si parashikon të garantojë shlyerjen e rifinancimit dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të licencuar;

- germën “f”: shoqëria duhet të japë informacion për efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit;

- germën “g”: shoqëria duhet të japë informacion për efektin në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar;

- germën “h”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE listën e aseteve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, me vlerën e secilit aset dhe vlerën totale të tyre, listë e cila duhet të jetë pjesë integrale e marrëveshjes së hipotekës, si dhe të sqarojë pozicionin e bashkëkredimarrësit në marrëveshjen e kredisë. Po ashtu, duhet të depozitojë marrëveshjen e kredisë sindikale dhe atë të hipotekës në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

- germën “j”: shoqëria duhet të informojë nëse ka pasur më herët transferime të aseteve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar;

- Pika 3: shoqëria duhet të depozitojë korrespondencën e zhvilluar me MIE-n në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

- Pika 6: shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë në ERE që kërkon të mos jetë e hapur për publikun.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj marrëveshjes së kredisë sindikale, të nënshkruar me “Raiffeisen Bank” sh.a., “OTP Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a. dhe “Tirana Bank” sh.a., ku agjent i kredisë dhe i kolateralit është “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Ayen AS Energji” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasi Bujar Jafelezi, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Ermir Jafelezi, me atësi Selim dhe amësi Xhevë, i lindur më 17.1.1981, në Tropojë, dhe me vendbanim të fundit në Tiranë, si dhe caktimin e kërkuesit si kujdestar të pasurisë së tij.

KËRKUES
Bujar Jafelezi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 80 lekë